



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Tiranë, më 16.7.2019

**RAPORT
PËR PROJEKTLIGJIN
“PËR MBROJTJEN CIVILE”**

- Hyrje

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjet e datave 8.7.2019, 15.7.2019 dhe 16.7.2019 mori në shqyrtim projektligjin “Për mbrojtjen civile”.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktoi relator për shqyrtimin e këtij projektligji deputetin Edmond Leka.

Në mbledhjet e Komisionit për të paraqitur dhe mbrojtur projektligjin, si dhe për të dhënë shpjegime ishin të pranishëm, përfaqësues të Ministrisë së Mbrojtjes.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78, 83, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

II. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT E TIJ

Projektligji ka si qëllim zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe realizimin e mbrojtjes civile për të garantuar mbrojtjen e jetës së njerëzve, të pronës, të gjësë së gjallë, të trashëgimisë kulturore dhe të mjedisit, nëpërmjet forcimit të sistemit të mbrojtjes civile.

Projektligji rregullon funksionimin e sistemit të mbrojtjes civile, duke përcaktuar qartë përgjegjësitë e institucioneve dhe të strukturave të këtij sistemi, bashkëpunimin

ndërkombëtar, të drejtat dhe detyrimet e shtetasve dhe të subjekteve private, edukimin, trajnimin dhe inspektimin në fushën e mbrojtjes civile.

Objektivat e këtij projektligji janë:

- a) Zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë, nëpërmjet identifikimit të saktë, vlerësimit periodik të riskut dhe monitorimit të tij;
- b) Forcimi i sistemit të mbrojtjes civile, nëpërmjet krijimit të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile;
- c) Forcimi i kapaciteteve administrative, teknike dhe financiare të sistemit të mbrojtjes civile në tërësinë e tij,
- d) Përmirësimi i edukimit për mbrojtjen civile në shkolla, nëpërmjet përfshirjes së lëndëve përkatëse arsimore në nivelin arsimor parauniversitar.
- dh) Mirëfunksionimi i sistemit të paralajmërimit të hershëm, i monitorimit, njoftimit dhe alarmit, duke përcaktuar detyrat për institucionet përgjegjëse dhe subjektet private, të përfshirë në të.
- e) Parashikimi i rregullave më të qarta të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe atij ndërinstitutional në kuadër të asistencës ndërkombëtare dhe të procedurave përkatëse;
- ë) Rritja e rolit ndërkombëtar të Republikës së Shqipërisë në fushën e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile;
- f) Rritja e rolit të të gjithë aktorëve shtetërorë, individëve dhe subjekteve private në zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile dhe nëpërmjet përcaktimit të të drejtave e detyrave që ato kanë në këtë fushë.
- g) Planifikimi dhe realizimi sa më cilësor i masave strukturore dhe jostrukturore në fushën e zvogëlimit të riskut të fatkeqësive dhe mbrojtjes civile;
- gj) Zbatimi më i mirë i detyrave dhe i përgjegjësisë të të gjithë aktorëve të sistemit të mbrojtjes civile.

III. REKOMANDIME PËR KOMISIONIN PËRGJEGJËS

Gjatë diskutimit të projektligjit në Komision nga relatori dhe nga deputetët anëtarë të Komisionit u trajtuan disa çështje lidhur me përgjegjësitë që sipas projektligjit u ngarkohen organeve të vetëqeverisjes vendore. Në veçanti u diskutua detyrimi i parashikuar në nenet 28 dhe 65 të projektligjit që 4% e buxhetit vjetor të bashkive duhet të planifikohet për mbrojtjen civile. Lidhur me këtë detyrim anëtarët e komisionit rekomanduan që këto parashikime duhet të vlerësohen në raport me parimet e autonomisë së njësive të vetëqeverisjes vendore, të cilat kanë autonomi të plotë fiskale në përcaktimin e mënyrës së përdorimit të fondeve të veta buxhetore.

Në ligjin 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore përcaktohet” se: *“Transfertë e kushtëzuar” është një transfertë nga Buxheti i Shtetit apo të tretë për njësitë e vetëqeverisjes vendore, që përdoret vetëm për funksionin e deleguar, apo për projekte të veçanta ...”*.

Për këtë arsye, duke qenë se me këtë projektligj parashikohen disa funksione të reja që njësitë e vetëqeverisjes vendore do të kryejnë në kuadër të mbrojtjes civile, parashikimi dhe shtesa e fondeve duhet të bëhet vetëm brenda fondit të transfertës së kushtëzuar. Prandaj

Komisioni për Çështjet Ligjore vendosi t'i rekomandojë komisionit përgjegjës riformulimin e neneve 28 dhe 65 të projektligjit, ku të parashikohet që niveli 4% i buxhetit për mbrojtjen civile të llogaritet vetëm mbi transfertën e kushtëzuar që u jepet bashkive nga buxheti i shtetit, dhe ja nga të ardhurat e tjera të bashkive.

Gjithashtu, Komisioni për Çështjet Ligjore për Çështjet Ligjore rekomandon edhe riformulimin e nenit 41 të projektligjit, që parashikon të drejtën e kompensimit, duke përcaktuar se në rastet kur bashkitë nuk kanë fonde të mjaftueshme për kompensimin, Komiteti i Mbrojtjes Civile vendos që kompensimi të kryhet nga AKMC-ja. Gjithashtu në këtë nen duhet të rishikohet dhe vlera e kompensimit që do të mbulojnë bashkitë.

IV. RREGULLIME TË TEKNIKËS LEGJISLATIVE SIPAS NENEVE

Në përfundim të shqyrtimit dhe diskutimit të projektligjit, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, gjatë shqyrtimit nen për nen të këtij projektligji, miratoi dhe përcjell komisionit përgjegjës këto propozime:

Së pari, konstatohet se në projektligj, në tërësi, është e nevojshme të bëhet një redaktim i teknikës legjislative, pasi për shkak të përjasjes me direktivën evropiane, vihet re përdorimi i termave apo formave të foljeve që nuk janë të përshtatshme për një dispozitë ligjore.

Për nene të veçanta paraqiten këto propozime dhe rekomandime për Komisionin përgjegjës:

Neni 3

Në këtë nen të jepet përkufizimi i vërtetimit të riskut.

Neni 11

Në këtë nen, togfjalëshi “çdo pesë vjet” të zëvendësohet me togfjalëshin “çdo katër vjet”.

Neni 13

-Për qartësi të dispozitës, pika 2 të bëhet pika 1 e nenit, pasi duhet sqaruar në fillim të nenit se ç'përmban vërtetimi i riskut.

-Ne pikën 6 të nenit, të përcaktohet që është gjykata administrative ku bëhet ankimi.

Neni 26

Në pikën 2 të nenit, të parashikohet që të jetë ministria përgjegjëse e cila përcakton përbërjen detyrat dhe funksionet e qendrave të mbrojtjes civile në qark.

Neni 55

Në pikën 1 të nenit, në fund të shtohen fjalët “sipas legjislacionit në fuqi”.

Neni 64

Pika 1 të riformulohet, pasi buxheti i ministrive është pjesë e buxhetit të shtetit, dhe nuk është e nevojshme të ndahen më vete. Prandaj pika 1 riformulohet:

“1.Buxheti i mbrojtjes civile të institucioneve qendrore përbëhet nga buxheti vjetor i çdo ministrie, i parashikuar zë më vete, për zvogëlimin e riskut të fatkeqësive dhe mbrojtjen civile.”

Neni 67

Në këtë nen, shkronja “c” e pikës 2 të hiqet, pasi planifikimi i fondeve nuk mund të jetë objekt inspektimi. Planifikimi i fondeve për institucionet qendrore dhe vendore bëhet sipas parashikimeve të ligjeve respektive për buxhetin.

Neni 68

-Në këtë nen, togfjalëshi “*Shkelja e njërës prej dispozitave të parashikuara në shkronjat*” të zëvendësohet me fjalët “*shkelja e kërkesave të parashikuara në shkronjat*”.

-Gjithashtu, në pikën 1, rekomandohet që masa e gjobës të përcaktohet me interval, në masën 100 000-200 000 lekë, pasi kemi të bëjmë me disa lloje shkeljesh, me rëndësi të ndryshme.

V. PËRFUNDIM

Në përfundim, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, konstatoi se :

- Në aspektin ligjor, projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;
- Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit;

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, me votat e anëtarëve të pranishëm e miratoi atë, dhe u shpreh dakord për kalimin për votim në seancë plenare.

R E L A T O R

EDMOND LEKA

K R Y E T A R

ULSI MANJA